

BASHKIA KORCE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Date 05.11.2015

Nga: Bashkia Korçe, rruga “28 Nentori”, 082 243353.

Për: Shoqeria “Curri” sh.p.k NIPT J67902718S , adresa: Shkoder, Koplik

Procedura e prokurimit: Proçedure e hapur

Objekti: “Rikonstruksion i Teatrit Andon Z Çajupi”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Rikonstruksion i godines te Teatrit Andon Z Çajupi

Fondi limit: 115.664.515 lek

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit +Te ardhurat e Bashkise
Investim

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: 08.10.2015

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] – Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. Shoqeria “Curri”sh.p.k, NIPT J67902718S me vlere:
111.855.314(njeqind e njembdhjete milion e teteqind e pesedhjete e pese mije e treqind e katermbdhjete)lek
2. Shoqeria “Çausi”sh.p.k Nuk ka paraqitur oferte
3. Shoqeria “Salillari”sh.p.k, NIPT J62903125G me vlere:
84.339.512(tetedhjete e kater milion e treqind e tridhjete e nente mije e peseqind e dymbdhjete)lek
4. Bashkimi i operatoreve ekonomike Shoqeria “Beladi”sh.p.k, NIPT J62903254C dhe Shoqeria “Beqari”sh.p.k, NIPT J64103603J me vlere:
110.049.177(njeqind e dhjete milion e dyzet e nente mije e njeqind e shtatedhjete e shtate)lek
5. Bashkimi i operatoreve ekonomike Shoqeria “Xhengo”sh.p.k, NIPT J64103171M dhe Shoqeria “Meni”sh.p.k, NIPT J61909018W me vlere:
113.099.093(njeqind e trembedhjete milion e nentedhjete e nente mije e nentedhjete e tre)lek

Jane s’kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Shoqeria “Çaushi”sh.p.k

Arsyet:

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike, si dhe asnje nga dokumentat e kerkuara, ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

2. Shoqeria “Salillari”sh.p.k

Arsyet:

1-Ne preventivin e punimeve ,pika 10.Punime fasade,ne zerin “Veshje e fasades me pllaka qeramike (80x80) te derdhura,me maska konkave te personalizuar” mungon cmimi per njesi (eshte vendosur zero) dhe si rrjedhim nuk eshte llogaritur ne cmimin total te punimeve.

2-Nuk ploteson kriterin lidhur me punet e ngjashme te percaktuar ne dokumentet e tenderit,shtojca 10,kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti teknik,pika2.2 ku percaktohet shprehimisht:

” Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme ,ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit eshte sa dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet.

a)-Per kontrata te realizuara me Institucione shteterore, duhet te paraqitet kontrata,formulari I vleresimit sipas shtojces 8, akt kolaudimi dhe situacion perfundimtar.

b)-Per kontrata te realizuara me subjekte private, duhet te paraqitet kontrata,leja ndertimit, situacioni perfundimtar, akt i kolaudimit dhe leja perdorimit.”

Per arsye se :-Kontrata me objekt “Ndertimi i shkollave te reja ne Shishtufine dhe Fonderia” eshte lidhur ne daten 28.02.2007 dhe ka perfunduar ne daten 18.09.2012, pra nuk eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.

-Per Kontraten me objekt “Kantjeri Marikaj, Ndertese administrative 4KT Magazine dhe vendqendrim automjetesh 1 dhe 2 KT ne fshatin Marikaj” nuk eshte paraqitur leja e perdorimit. 3-Listpagesat 2014 jane te palexueshme

4- Nuk ploteson kriterin lidhur me dokumentacionin e kerkuar per materialet ne dokumentet e tenderit,shtojca 10, kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti teknik,pika 6 per arsye se:

-Per materialet qe do te perdoren per punimet e muratures eshte paraqitur autorizim prodhuesi me ane te se cilit shoqeria “Progips” sh.p.k autorizon shoqerine “Salillari” sh.p.k te perdore materialet e gipsit sipas specifikimeve teknike .

Ky autorizim nuk eshte shoqeruar me skeda teknike dhe certifikaten e bioarkitektures e per materialin “pllaka” dhe skeda teknike per materialet ”lesh guri” dhe “vida”

Jane paraqitur gjithashtu disa skeda teknike,certifikata te ndryshme dhe deklarata performance te shoqerise “Knauf” te cilat jane te pa perkethyera dhe te pa shoqeruara me autorizimin e prodhuesit,shoqerise “Knauf”.

-Per materialet dyer dhe dritare nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomike Shoqeria “Beladi”sh.p.k & Shoqeria “Beqari”sh.p.k Arsyet:

1. Shoqeria Beqari sh.p.k nuk ploteson kriterin lidhur me punet e ngjashme te percaktuar ne dokumentet e tenderit, shtojca 10, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.2 ku percaktohet shprehimisht:

” Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme ,ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit eshte sa dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet.

a)-Per kontrata te realizuara me Institucione shteterore, duhet te paraqitet kontrata, formulari I vleresimit sipas shtojces 8, akt kolaudimi dhe situacion perfundimtar.

b)-Per kontrata te realizuara me subjekte private, duhet te paraqitet kontrata, leja ndertimit, situacioni perfundimtar, akt i kolaudimit dhe leja perdorimit.”

Per arsye se :

Shoqeria Beqari nuk ka paraqitur kontrate, leje ndertimi dhe leje perdorimi , gjithashtu dhe situacioni i paraqitur nuk eshte perfundimtar.

2. Shoqeria Beqari nuk ka paraqitur asnje nga certifikatat ISO, te percaktuar ne dokumentet e tenderit, shtojca 10, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 5 , ne kundërshtim me nenin 74 pika 3 te VKM Nr 912 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit public” ku percaktohet shprehimisht se “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

4. Bashkimi i operatoreve ekonomike Shoqeria “Xhengo” sh.p.k & Shoqeria “Meni” sh.p.k Arsyet:

Nuk ploteson kriterin lidhur me punet e ngjashme te percaktuar ne dokumentet e tenderit, shtojca 10, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.2 ku percaktohet shprehimisht: “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë prej 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme ,ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit eshte sa dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet.

a)-Per kontrata te realizuara me Institucione shteterore, duhet te paraqitet kontrata, formulari i vleresimit sipas shtojces 8, akt kolaudimi dhe situacion perfundimtar.

b)-Per kontrata te realizuara me subjekte private, duhet te paraqitet kontrata, leja ndertimit, situacioni perfundimtar, akt i kolaudimit dhe leja perdorimit.” Per arsye se :

-Kontrata me objekt “Rikonstruksioni i objekteve ne N/stacionin 400/110 kV Zemblak Korce” eshte lidhur ne daten 20.12.2011 dhe ka perfunduar ne daten 04.06.2012, pra nuk eshte realizuar gjate tre viteve te fundit.

Shoqeria “Xhengo” sh.p.k nuk ploteson numrin e kerkuar te punetoreve ne perputhje me perqindjen qe ka marre persiper te kryeje ne aktmarrveshje

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqerine, “Curri” sh.p.k NIPT J67902718S, adresa Shkoder, Koplik se oferta e paraqitur me vleren : 111.855.314(njeqind e

njembdhjete milion e teteqind e pesedhjete e pese mije e treqind e katermbdhjete)lek është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Korçe kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do te veprohet, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike Nr 9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 28.10.2015

